

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2008

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI B

E hënë, 9 qershor 2008

Ora 10.00

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**

**Shkolla e mesme e përgjithshme (drejtimi shoqëror; drejtimi i përgjithshëm)**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në tragjedi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rretho **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	9	10	11a	11b
Pikët													
Kërkesa	11c	12a	12b	13	14	15	16	17	18	19a	19b	20a	20b
Pikët													
Kërkesa	21	22	23a	23b	23c	24	25a	25b	25c	25d			
Pikët													

**Totali i pikëve**

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****Migjeni****Historia e njenës nga ato**

(Fragment)

Në një katund që don të quhet qytet. Stacioni i fundit automobili. Mbrapa nga lindja s'ka ma rrugë të gjana, por rrugë kuajsh. Njerëzit që vijnë në këto anë, vijnë vetëm nga shtrëngesa e jetesës. (Mund të shifet edhe ndonjë turist i huej).

Një ditë kur automobili i postës nisej nga katundi që don të quhet qytet, për qendër prefekturë, erdhi në mes dy gjindarmve, një grue me duer lidhë.

- U Lukja, - briti njeni nga njerëzit që ishin mbledhë rreth automobilit.
- Po nga kjo kështu?
- Ku paska qenë?
- Pse me dy gjindarmët?
- Paska ba ndoj horllëk...
- Shiko, edhe duert ia paskan lidhë...

E Lukja, nga ana e saj, shikonte njerëzit dhe buzëqeshte.

- U, pse m'i kanë lidhë duert- ej?- Hihi...
- Paska dalë menç, - u dëgjue nga turma.
- E shkreta, -tha një malësore tue kalue me barrë karthjash mbi shpinë.

Dhe njerëzit filluen të lozin me fjalë, tue ia kujtue Lukes së çmendun jetën e kalueme. E ajo, shikonte me at shikim të marrit dhe buzëqeshte:

- Hi-hi-hi...Po pse m'i kanë lidhë duert...hi-hi-hi.

Një djalosh, gjysmë nëpunësi, s'di, seriozisht apo për tallje, ia dorëzoi një tufë lule të vyshkuna- s'di se ku i kish gjetë. E ajo me një lëvizje komplimentuese tue buzëqeshë, e falnderoi:

- Falnderës, i dashtuni zotni! Hi-hi-hi- dhe mudohej t'i mbajë lulet drejt ndër duert e lidhuna.

Automobili u nis. Dhe Lukja, me fytyrë të nxime nga vuajtja, me ata sy të marri me at hi-hi-hi, shkoi në çmendinë. Në çmendinë me at hi-hi ka me tregue historinë e jetës së vet. Por të pakët kanë me qenë ata që kanë me e kuptue at' hi-hi-hi.

Burri i saj, kallajxhiu vagabond (shëtitës), atje, në ndonjë fshat të humbun të malsis, nga e kish dërgue Luken në çmendinë, kallaiste dhe ndoshta qeshte për fatin e asaj kurvës, që ishte gruaja e tij:

- Shyqyr, u shporra soje.

*Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

1. Bashkëshorti i Lukes, "kallajxhiu vagabond", e përjeton fundin e saj me:

1 pikë

- A) dhimbje.
- B) ftohtësi.
- C) kënaqësi.
- D) urrejtje.

2. Është shembull i ironisë shprehja:

1 pikë

- A) një katund që don të quhet qytet.
- B) një grue me duer lidhë.
- C) të pakët kanë me qenë ata që kanë me e kuptue.
- D) vijnë vetëm nga shtrëngesa e jetesës.

3. Ndërtimi i **veçantë sintaksor** i fjalisë: “*Stacioni i fundit automobili*” nënkupton një: **1 pikë**
- A) katund, i cili ka një stacion automobili.  
 B) katund të mbytur nga monotonia.  
 C) katund, ku ngjarjet ndodhin në stacion.  
 D) katund, ku stacioni është pikë lidhëse me qytetin.
4. Autori thotë se historinë e Lukes pak njerëz kanë për ta kuptuar, sepse: **1 pikë**
- A) Lukja është e çmendur dhe nuk mund të tregojë se çfarë i ka ndodhur.  
 B) kjo është një shoqëri që më shumë priret të gjykojë se të kuptojë.  
 C) liria e gruas është një koncept i ri për ta.  
 D) ka pak njerëz të shkolluar që e dinë ç’është prostitucioni.
5. Autori në këtë fragment priret të na tregojë: **1 pikë**
- A) një katund që përpiqet të marrë trajtat e qytetit.  
 B) ngjarjet e jashtëzakonshme që ndodhin në këtë vend.  
 C) ndryshimet që vijnë nga tronditjet e mëdha.  
 D) fundin tragjik të një jete.
6. Kush shpreh keqardhje për Luken në këtë fragment? Shpjego arsyen e kësaj keqardhjeje. **2 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
7. Gjej mjetet e stilistikës me ilustrimet përkatëse (të paktën dy), me anën e të cilave është realizuar portreti i Lukes në këtë fragment. Ç’efekt shkakton kjo mënyrë e përshkrimit të saj? **3 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
8. Si është formuar fjala *horllëk*? Ç’ngjyrim stilistikor mbart kjo fjalë? **2 pikë**
- a) formimi: \_\_\_\_\_
- b) ngjyrimi stilistikor: \_\_\_\_\_

9. Përshkruaj mjedisin ku zhvillohet ngjarja në këtë fragment. Cili është funksioni artistik i një zgjedhjeje të tillë nga ana e shkrimtarit?

3 pikë

---

---

---

---

10. Migjeni theu disa tabu tematike në këtë novelë. Zbulo në këtë fragment një prej tyre.

1 pikë

---

11. Ka raste kur Migjeni e nis fjalinë me një lidhëz bashkërenditëse shtuese. Gjej dy raste të tilla në fragment dhe shpjego arsyen e këtij përdorimi.

3 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

c) arsyeja e përdorimit: \_\_\_\_\_

---

12. Ku ndryshon paragrafi i parë i këtij fragmenti nga e gjithë pjesa në vazhdim? Përqendrohu në kohën e foljeve dhe stilin e rrëfimit.

2 pikë

a) koha e foljeve: \_\_\_\_\_

b) stili i rrëfimit: \_\_\_\_\_

---

**PJESA II****Shekspir****Makbethi**

(Fragment)

**AKTI II, Skena II****ZONJA MAKBETH**

- 1** Ajo që ata i dehu ma forcoi kurajën  
Ajo që i shoi ata, ma ndezi zjarrin.  
Hesht! Hesht! Degjo!  
Ish kukuvajka vajtimtare që na klithi
- 5** Dhe mbrojtur na uroi natën e mirë.  
Po i përvishet; dera është çelur  
Dhe shambellanët barkpërmbytur qesëndisin  
Ua përzjeva me ilaç të pirat  
Detyrën vigjëllore me gërritje.
- 10** Se vdekja dhe natyra po përleshën,  
Se s’ dihet vallë a rrojnë, a kanë vdekur.

**MAKBETHI**

(përbrenda) Kush është atje? Eh. Eh!

**ZONJA MAKBETH**

- Ajme! Kam frikë mos u zgjuan dhe s’u bë  
Përnisja dhe jo vepra na trondit më tepër
- 15** Dëgjo! Gati ua lashë kamat të dyve;  
Nuk është e mundur që të mos i kenë gjetur  
Sikur të mos i shembëllente babës.  
Kur flinte, do ta kisha bërë vetë.  
Imzot (Hyn Makbethi)

**MAKBETHI****20** E bëra! Nuk dëgjove shamatë?**ZONJA MAKBETH**Dëgjova kukuvajkën që këlthiste,  
Mos the gjëkafshë?**MAKBETHI**

Kur?

**ZONJA MAKBETH**

Tani?

**MAKBETHI****25** Kur zbrisja?**ZONJA MAKBETH**

Po

**MAKBETHI**

Dëgjo! Kush fle në odën e dytë?

**ZONJA MAKBETH**

Donalbani

**MAKBETHI**

(Duke shikuar duart). Kjo pamje më vret syrin.

**ZONJA MAKBETH****30** Ç’ më thua se të vraka syrin?**MAKBETHI**Një qeshi në ëndërr dhe një thirri: “Vrasje!”  
Sa që të dy u zgjuan: ndenja dhe dëgjova;  
U falën dhe i zuri prapë gjumi.**ZONJA MAKBETH**

Kjo punë s’do mejtuar me këtë mënyrë,

**35** Sepse kështu do të marrosemi.**MAKBETHI**

- M’u duk sikur një zë më thirri: “Mos fli  
më!  
Makbethi vrau gjumin! Gjumin e  
pafajshëm.  
Gjumin që shqit përleshjen e kujdesit.  
Vdekjen e jetës së përditshme,
- 40** Banjën e punës trupkapitëse,  
Ballsamn’ e shpirtit të vrar’ e plagosur,  
Gjellën e dytë të natyrës së madhe  
Kryeushqyesen e dasmës s’jetës”.

**ZONJA MAKBETH**

Ç’do më thuash?

**MAKBETHI****45** Dhe prapë thirri e oshtiu: “Mos fli më!  
Glamsi ka vrarë gjumin, Kodri pra  
S’fle më. Makbethi nuk fle dot më”!**ZONJA MAKBETH**

- Kush ish ai që thirri ashtu? Për Zotin,  
Po e shkallmon fuqinë e shpirtit tënd
- 50** Dhe po sëmuresh me këto mendime.  
Shko shpejt e merr ca ujë dhe laj  
Nga duart atë dëshmi të ndyrë.  
Ç’ m’i solle këto kama prej andej?  
Duhet t’i lësh atje; shko, shpjeri prapë
- 55** Dhe shambellanët lyeji me gjak.

**MAKBETHI**

S'vete dot më,  
Kam frikë të mejtohem se ç'kam bërë  
Ta shoh me syrin përsëri s'guxoj.

**ZONJA MAK BETH**

Vullnetsëmurë! Nëmi mua kamat.

- 60** Të vdekurit dhe të fjeturit  
Nuk janë veç piktura. Syri i foshnjës vetëm  
Ka frikë nga një djall i pikturuar.  
Me gjak, në i rrjedhtë akoma, ua lyej  
Fytyrat shambellanëve të fjetur.
- 65** Atyre do t'jua ngarkojmë fajin.  
(Del. Trokitje përbrenda)

**MAKBETHI**

Kush po troket në derë? Qysh u bëra  
Që çdo shamatë më tmerron, më ngjeth?  
Qysh i kam duart. Ma vrasin syrin!  
Vall e lan dot ujt' e oqeanit,

**70** Prej kësaj dore gjakun? Jo, kjo dorë.  
I skuq dhe i përgjak të gjitha detet  
(Hyn prapë zonja Makbeth)

**ZONJA MAK BETH**

Si ti i kam edhe unë duart  
Po më vjen turp ta kem të bardhë zemrën

- 75** Ashtu siç e ke ti, (Trokitje përbrenda)  
Dikush troket  
Nga dera e jugës; shkojmë shpejt në  
dhomë,  
Pak ujë na shpëlan prej kësaj veprë;  
Sa lehtë do të jetë atëherë!
- 80** Qëndresa të ka neveritur fare  
(Trokitje përbrenda)  
Dëgjo trokasin prapë. Shko e vish  
Rrobën e natës se mos na thërresin  
Dhe shohin që s'kemi fjetur edhe.  
Shko, mos u mbyt ashtu në mendime.

**MAKBETHI**

- 85** Kur e mendoj më vjen prej vetes ndot.  
(Trokitje)  
Trokit, e zgjo! Sikur ta bëja dot. (Dalin)

Për pyetjet 13-17 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

**13.** Imazhi më i fortë në këtë skenë është:

**1 pikë**

- A) duart me gjak.  
B) fytyrat me gjak të shambellanëve.  
C) kamat me gjak.  
D) uji që lan gjakun.

**14.** Në vargun: “Vdekja dhe natyra po përleshën” nënkuptohet:

**1 pikë**

- A) lufta midis jetës dhe vdekjes.  
B) lufta midis së mirës dhe së keqes.  
C) lufta midis të kundërtave në natyrë.  
D) lufta për të zotëruar mbretërinë.

**15.** Alternativa që shpreh më mirë idenë e këtij fragmenti është:

**1 pikë**

- A) urrejtja ekstreme nuk sjell asnjë dobi.  
B) vdekja është si tmerri apo si një ëndërr e pakëndshme.  
C) fajësia shkakton vizione dhe halucinacione.  
D) njeriu nuk i shpëton dot fatit të paracaktuar.

**16.** Makbethit i vjen ndot nga vetja e tij (fundi i fragmentit), sepse:

**1 pikë**

- A) ka frikë nga vrasja që ka bërë.  
B) nuk e duron dot gjakun.  
C) nuk e duron dot mendimin se është më i dobët se e shoqja.  
D) e tmerron vrasësi ordiner që është brenda tij.

17. Përdorimi i imazhit të kukuvajkës nënkupton:

1 pikë

- A) dobësinë që po shfaqet te Makbethi.
- B) çmendurinë te Makbethi.
- C) tensionin që ekziston midis çiftit.
- D) përafrimin e vdekjes.

18. Cila është arsyeja që Zonja Makbeth nuk e vrau vetë Dulkanin kur ai po flinte?

1 pikë



---



---

19. Kjo tragjedi ka shumë imazhe gjaku. Cili është kuptimi i dyfishtë i tij?

2 pikë

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

20. Gjej figurën e stilistikës në vargun: “*Makbethi vrau gjumin!*”.

Interpreto nëntekstin e tij.

3 pikë

- a) figura e stilistikës: \_\_\_\_\_
- b) interpretimi: \_\_\_\_\_

---

21. Vrasja e mbretit Dulkan nuk ndodh përpara syve të spektatorit, por prapa skenës.

Pse Shekspiri ka zgjedhur një teknikë të tillë?

2 pikë



---



---

22. Ç’efekt krijon, nga pikëpamja psikologjike, trokitja në derë në vargun: “*Kush po troket në derë? Qysh u bëra?*”?

1 pikë



---



---

23. Gjej në fragment dy fjalë të përbëra. Trego si është formuar njëra prej tyre.

3 pikë

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) formimi: \_\_\_\_\_

24. Kur zhvillohet kjo skenë, ditën apo natën? Cili është funksioni artistik i saj?

Ilustroje mendimin tënd me detaje nga fragmenti (të paktën dy).

4 pikë



---



---



---

25. Lexo me kujdes fragmentin e dhënë më sipër, pastaj në një ese të organizuar mirë krahaso Makbethin me zonjën Makbeth. Ku ndryshojnë ata të dy? Si ndikojnë **detajet e përzgjedhura** dhe **imazhet e krijuara** nga Shekspiri për të dhënë këtë ndryshim?

**8 pikë**

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

Shtjellimi i idesë (25a)	Organizimi dhe struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d)	<b>Totali</b> <b>25</b>
<b>2 pikë</b>	<b>2 pikë</b>	<b>2 pikë</b>	<b>2 pikë</b>	<b>8 pikë</b>